



STUDIO LEGALE
AS&T
Aviation Shipping & Trade

AS&T

aviation shipping & trade



STUDIO LEGALE ASSOCIATO DI DIRITTO
DEI TRASPORTI E DEL
COMMERCIO INTERNAZIONALE

LET E R K R E D I A

1. Letër Kredia

- është praktika nëpërmjet të cilës banka (Banka nënshkruese), me kërkesë të një Importuesi (Porositësi), detyrohet të paguajë Shitësin (Përfituesin), pasi të jetë verifikuar që dokumentet e prezantuara pranë kësaj banke (brenda një kohe të parapërcaktuar) janë në konformitet të plotë me çfarë është kërkuar në udhëzimet e dhëna nga Shitësi.

Banka mund
të ndërmarrë
një impenjim

të revokueshëm

të pa revokueshëm

Vetëm në rastin e parë

Banka nënshkruese ka të drejtë të anuloj
letër kredinë në çdo moment.



Për këtë motiv, sipas normave të praktikës
kërkohet nënshkrimi i letër kredive të
revokueshme.

2. Çelja e letër kredisë konsiderohet si një veprim i ndryshëm dhe i pavarur nga kontrata e shitjes.

Shembull: Në praktikë Banka nënshkruese është e detyruar të paguajë Shitësin, edhe pse Porositësi kundërshton pagesën duke paralajmëruar bankën për zgjidhjen e kontratës së shitjes.

Kazus: _____

3. Në raport me letër kredinë marrin pjesë të paktën tre subjekte:

- Porositësi (Importuesi/Blerësi)
- Banka nënshkruese (banka nëpërmjet të cilës Importuesi kryen pagesën)
- Përfituesi (Eksportuesi/Shitësi)

4. Si rregull në praktikë Banka nënshkruese angazhon edhe një subjekt të katërt, që mund të ndërmarre rolin e;

- Bankës lajmëruese ose njoftuese
- Bankës së përcaktuar
- Bankës konfirmuese

5. Subjekti i katërt i angazhuar (p.sh., Banka konfirmuese), është banka e autorizuar të kryejë shërbimin e kërkuar duke shtuar konfirmimin e saj, ose duke ndërmarrë impenjimin e parevokueshëm për të kryer pagesën në favor të përfituesit.

6. Banka nënshkruese çel (hap) letër kredinë sipas udhëzimeve të Porositësit, dhe ndërmerr angazhimet e mëposhtme.

- Banka detyrohet të kryejë pagesën me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar.
- Banka duhet të respektojë detyrimin e saj për verifikimin e dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e letër kredisë.

7. Të gjitha letër kreditë duhet të përmbajnë treguesin që pagesa është në favor të përfituesit e cila mund të jetë:

- Pagesë direkte
- Pagesë e ndarë në periudha: skadencia mund të koinçidojë me përcaktimin e një date ose të një ngjarjeje
- Pranimin nga Banka nënshkruese ose konfirmuese.

8. Fusha e letër kredisë është e disiplinuar nga "UCP" (Uniform Customs and Practice)

- publikimi nr. 500, botimi 1993, i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare të Parisit (hyrë në fuqi në 1 janar 1994) dhe,
- botimi i fundit nr. 600, që do të hyjë në fuqi me 1 korrik 2007.

9. Disa vende i konsiderojnë UCP-të si linja drejtimi për praktikat bankare, vende të tjera i konsiderojnë si mjete për interpretimin e ligjit dhe për krijimin e legjislationit në fushën e letër kredisë.

10. Përgjegjësitë e Bankës Nënshkruese dhe Konfirmuese.

- Janë të detyruara të kryejnë pagesën pasi të jenë verifikuar që dokumentet “janë në konformitet me afatet dhe kushtet e kredisë”.
- Nuk janë përgjegjës për mos kryerjen e detyrave kur këto kanë lidhje me rastet e forcës madhore (si p.sh. luftërat, përmbytjet, tërmetet, grevat), (neni. 7 UCP 500).

- Janë të përjashtuara nga përgjegjësitë në rastet e pavlefshmërisë së dokumenteve të prezantuara nga përfituesi kur këto të fundit janë formalisht të rregullta.
- Nuk janë përgjegjëse për vonesa, humbje, gabime në dorëzimin e dokumentacionit ose përkthimit dhe interpretimit të gabuar të termave teknike në to të përdorura (neni. 16 UCP 500)

12. Në ekzaminimin e dokumenteve Banka është e detyruar që të ndjekë parimet e mëposhtme:

- Neni 13 UCP: në rast se kemi të bëjmë me mospërputhje të dokumenteve që paraqiten, këto të fundit nuk mund të konsiderohen konform me termat dhe kushtet e letër kredisë.
- Në rast se kemi të bëjmë me dokumenta që nuk janë të përfshira në letër kredinë, këto nuk do të ekzaminohen nga bankat.

- Neni. 22 UCP: Bankat janë të detyruara të shqyrtojnë që dokumentet të paraqesin një datë nënshkrimi paraprake nga data e nënshkrimit të letër kredisë.
- Neni 20 UCP: në rast se letër kredia kërkon që dokumentet të jenë autentike, të vlefshme, të çertifikuara o të pranuar, bankat shqyrtojnë vetëm ato dokumenta që në aparence plotësojnë atë çfarë kërkohet nga letër kredia.

12. Pasi të jenë shqyrtuar dokumentet, banka duhet të analizojë nëse këto janë të rregullta ose jo dhe vepron si më poshtë:

- Në rastin e parë banka kryen pagesën.
- Në rastin e dytë, banka kundërshton kryerjen e pagesës dhe njofton Përfituesin duke i evidentuar të gjitha parregullsitë. Njoftimi për parregullsitë duhet të bëhet me mjetet me të shpejta të komunikimit dhe gjithnjë jo më vonë se dita e shtatë e punës bankare nga momenti i dorëzimit të dokumenteve.

Në rast vonese, banka humbet të drejtën për
të evidentuar parregullsitë e dokumenteve,
dhe është e detyruar të kryejë pagesën dhe
pse dokumentet e prezantuara nuk janë të
rregullta.

13. Dokumentat për letër kredinë mund të jenë :

- dokumenta transporti
- dokumenta siguracioni
- fatura tregtare
- çertifikata sasive dhe cilësie
- packing lists
- dokumenta doganore

14. Një rëndësi të veçantë ka policë ngarkesa (B/L) (e disiplinuar nga neni. 23 UCP 500)

- Ajo duhet të përmbajë:
- Emrin e transportuesit (carrier) dhe firmën e tij, e ndjekur nga nënshkrimi as carrier, ose atë të kapitenit të anijes me nënshkrimin as master.
- Klauzola on board, që evidenton se malli është ngarkuar në bordin e një anije të caktuar.

- Portin e ngarkimit (*port of loading*) dhe portin e shkarkimit (*port of discharge*) që duhet të korrespondojnë me të dhënat e përcaktuara në letër kredinë.
- Numrin e origjinaleve
- Të gjitha afatet dhe kushtet e transportit.

CASH AGAINST DOCUMENTS

15. Paguesa me paraqitje të dokumenteve parashikon që, Shitësi të dorëzojë në një bankë të vendit të tij (banka transmetuese), dokumentet që vërtetojnë spedicionin e mallit dhe ngarkon bankën e tij që t'ia transmetojë bankës së vendit të Blerësit (banka e prezantuar) dokumentacionin vetëm pasi të jetë kryer pagesa e mallit.

Kjo forme pagese bazohet në faktin që këto dokumenta janë të nevojshme për Blerësin në mënyrë që të marrë në dorëzim mallin, dhe një gjë të tillë ai mund ta kryejë vetëm pasi të ketë paguar çmimin e tij.

Pagesa me paraqitjen e dokumenteve

është një mjet jo gjithmonë i sigurtë për të garantuar pagesën, për faktin se nuk është e rrallë që Blerësi, duke përdorur mjete të jashtëligjshme, arrin të marrë në dorëzim mallin pa tërhequr dokumentet në bankë, do të thotë pa kryer pagesën për çmimin e mallit.

Gjithashtu Shitësi nuk është i garantuar që Blerësi t' i japë udhëzime bankës për të paguar mallin, kurse nëpërmjet letër kredisë ai garantohet mbi detyrimin e ndërmarre në mënyrë independente nga banka nënshkruese ose konfirmuese.

AS&T

aviation shipping & trade



STUDIO LEGALE ASSOCIATO DI DIRITTO
DEI TRASPORTI E DEL
COMMERCIO INTERNAZIONALE

JU FALENDEROJME PER VEMENDJEN

AS&T Legal Albania

www.astlegal.com

Adresa: Durrës (AL),
Lagja nr. 1 Sheshi Taulantia.
Tel: +355 52 35860
Fax: +355 52 24293

Filialet: Bolgna – Milano – Roma
Ravenna – Torino – Venezia